

ASPEKTE TË EPISTEMOLOGJISË LETRARE SHQIPTARE: NGA KONTEKSTI I GJEOPOLITIKËS BIPOLARE NË KONTEKSTIN E INTEGRIMEVE GLOBALE

Arben HOXHA

Instituti Albanologjik i Prishtinës, Dega e Letërsisë, Prishtinë, Kosovë

E-mail: arbenhoxha69@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Epistemologjia letrare shqiptare, si pjesë integrale e identitetit kulturor shqiptar, ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e retorikës argumentuese për shprehjen e besnikërisë ndaj vlerave njohëse që janë ndarë dhe vazhdojnë të ndahen brenda hapësirave të caktuara gjeopolitike. Në këtë punim synohet të hidhet dritë mbi ndikimin hegjemon të diskursit politik, si “fuqi universale”, mbi diskursin e njohjes letrare si “forcë e veçantë” e saj, në kontekstin e gjeopolitikës bipolare dhe në kontekstin e integrimeve globale.

Fjalët kyçe: *epistemologjia, metodat, ideologjia, gjeopolitika, globalizmi, integrim, çntegrim.*

Key words: *epistemology, methods, ideology, geopolitics, globalization, integration, disintegration.*

HYRJE

Gjeopolitika si praktikë politike e raportit të forcave që mbështetet në faktorin e mjedisit dhe hapësirës territoriale, dhe si projektion i fuqive vepruese që buron prej marrëdhënieve reciprokisht të kushtëzuara ndërmjet shtetit dhe ideologjisë – që pas Luftës së Dytë Botërore e këtej – do të ushtrojë ndikim në konfigurimin e reliefit e të të menduarit dhe të njohurisë njerëzore në përgjithësi. Louis Althusser në veprën e tij *Ideologjia dhe aparatet ideologjike shtetërore* të

botuar për herë të parë më 1969, përpos fesë, sistemit politik, partive, sindikatave, mediave dhe sportit, në listën e aparateve ideologjike shtetërore, në mënyrë të veçantë, do të radhisë edukimin, letërsinë dhe artin [1].

Duke vështruar çështjen nga këndvështrimi altusserian mund të thuhet se epistemologjia letrare, si refleksion për letërsinë, përbën një nga segmentet e aparateve ideologjike. Pas Luftës së Dytë Botërore e këtej, ideologjia do të jetë ajo fuqi praktike materiale e gjeopolitikës, e cila do t’i përcaktojë dallimet konfiguracionale ndërmjet kategorive, koncepteve, teorive, metodave dhe modeleve metodologjike në sistemin epistemologjik letrar të zbatuar në Shqipërinë londineze dhe atë të zbatuar në hapësirën kulturore shqiptare brenda Jugosllavisë avnojane. Ajo, njëkohësisht do të provojë thënien e Jurgen Habremit se “procesi i njohjes është i pandarë nga interesi i njohjes”. Në të vërtetë interesi, si kategori e praktikës së njohjes, do të jetë ajo fuqi lëvizëse e cila do të përcaktojë përmasën e “objektivitetit shkencor”, si dhe kushtet e subjektivitetit njohës, si “vend” ku do të ndërthehen interesat ideologjike, politike, personale etj.

EPISTEMOLOGJIA LETRARE SHQIPTARE
DHE ZONAT GJEOPOLITIKE

Identiteti letrar kombëtar dhe refleksioni për letërsinë si përbërës i këtij identiteti, edhe pse është i ndërlidhur, para së gjithash, me etninë, popullin dhe me kombin si njësi kulturore e jo politiko-juridike dhe si i tillë ka fuqi t'i tejkalojë kufijtë administrativo-politikë dhe ata hapësinorë e vendorë. Megjithatë, në lëvizjen, në zhvillimin, në trajtat e ndryshimit të lëvizjes së tërësisë, të ndryshimit të raporteve të përmbajtjeve të pjesëve me njëra-tjetrën dhe të pjesëve me tërësinë, si dhe të ndryshimit të raportit të tipareve thelbësore me ato dytësore të tërësisë së këtij identiteti, në kontekstin e gjeopolitikës bipolare rol të rëndësishëm do të luajë marrëdhënia që identiteti letrar do të ketë me përbërësit e identitetin shtetëror: kufijtë administrativo-politikë, me natyrën e sistemit qeverisës, me modelet e ndërtimit të hierarkisë së institucioneve qeverisëse, si dhe me zonën e ndikimit të gjeopolitikës në të cilën do të bien strukturat e caktuara njohëse letrare [2].

Ndarja e Evropës në dy zona gjeopolitike në periudhën e pas Luftës së Dytë botërore do të jetë një nga faktorët që do t'i përcaktojë kufijtë e shtrirjes së ndikimit të qendrave-bërthamë të këtyre zonave në mënyrën dhe sasinë e ndarjes së vlerave kulturore, e me këtë edhe të koncepteve dhe modeleve metodologjike të njohjes letrare. Mënyra, sasia dhe cilësia e ndarjes së vlerave kulturore, në përgjithësi dhe e kriterëve për vlerat letrare, në veçanti, do të përcaktohet në varësi prej natyrës së sistemeve politike si dhe nga modelet mbizotëruese ideologjike mbi të cilat ato sisteme do ta ngrenë ngrehinën e tyre: të ideologjisë totalitare në pjesën e Evropës gjeopolitike lindore dhe të ideologjisë liberale në pjesën e Evropës gjeopolitike perëndimore. Sistemet politike të të dy blloqeve, njëra me qendër-bërthamë BRSS-në dhe tjetra me qendër-bërthamë SHBA-në, do të jenë ato struktura që do të përcaktojnë kriteret për vlerat, kriteret për cilësinë e vlerave, si dhe mënyrën dhe cakun e shpërndarjes së tyre.

Varësisht ashpërsimit apo zbutjes së raporteve në marrëdhëniet ndërkombëtare të këtyre dy qendrave-bërthamë, në vendet që do t'i takojnë arealit të ideologjisë komuniste, do të shfaqet fenomeni i dogmatizimit të mendimit

kritik letrar apo i "liberalizimit" të tij. Kështu, çtendosja relative e raporteve ndërmjet SHBA-së dhe BRSS-së, që do të vijë pas Kongresit të XX-të të PK të Bashkimit Sovjetik – si rezultat i zbatimit taktik të politikës së "bashkëjetesës paqësore" me SHBA-në – do të ushtrojë ndikim në procesin e destalinizimit dhe deetatizimit të kulturës në pjesën dërrmuese të vendeve të Evropës Lindore e Juglindore [3]. Për shkak se "konflikti ballkanik ndërmjet Jugosllavisë së Titos dhe Shqipërisë do të shërbejë si "perde" e ndarjes që kishte të bënte me "bashkëjetesën planetare dhe destalinizimin...", këto dy vende do të përbëjnë atë zonë në të cilën do të provohen mundësitë e jetëgjatësisë së konceptit të "bashkëjetesës paqësore" ndërmjet dy superfuqive: SHBA-së dhe BRSS-së; rrjedhimisht edhe mundësitë e vazhdimit të procesit të deetatizimit dhe destalinizimit të koncepteve për artin dhe kulturën në përgjithësi [4].

Në qoftë se në Jugosllavi procesi i deetatizimit dhe destalinizimit, që nga viti 1952, do të pësojë ngritje progresive, në Shqipëri procesi i "liberalizimit" kulturor e ideor i filluar në vitin 1958, pas prishjes së "bashkëjetesës paqësore" të të dy superfuqive që do të jetë rrjedhojë e marrëveshjes nukleare ndërmjet tyre në vitin 1963, të cilës do t'i paraprijë tërheqja e BRSS-së nga Kuba në vitin 1962 [5]. Në Shqipëri, që nga viti 1967, do të kemi kthim të konceptit të stalinizimit dhe etatizimit. Pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, nga viti 1968 deri në vitin 1971, do të kemi një rikthim të konceptit për "liberalizmin" e jetës kulturore e shkencore. Në këtë kohë to të shtohen zërat për nevojën e zgjerimit të përmbajtjes së konceptit të realizimit socialist, si teori dhe metodologji e hulumtimit letrar [6].

Afrimi i Shqipërisë me Kinën e Mao Ce Dunit do të shënojë edhe fundin e lojës me konceptin e "liberalizimit" (i vulosur në Plenumin e IV të KQ të PPSH-së në vitin 1974), i cili, kryesisht do të zbatohet për motive politike: herë si rezultat i pasigurisë për t'u gjetur dhe pozicionuar në kontekstin e përplasjeve apo të përfrimeve midis dy superfuqive, e herë si akt flirti për njërën apo palën tjetër. Lulahetjet e tilla të motivuara nga ndryshimet që ndodhnin në rrafshin e gjeopolitikës ndërkombëtare do të lënë gjurmë edhe në

relievin e identitetit kulturor shqiptar, prandaj, në këtë kontekst edhe në praktikën letrare si dhe në mendimin teorik e kritik letrar.

DY DOKTRINAT IDEOLOGJIKE

Doktrina e ideologjisë klasore në Shqipërinë londineze dhe liberalizmi si doktrinë e kolonializmit në Jugosllavinë avnojnë në fillimvitet 70-të në Kosovë, do të jenë dy forma hegjemone që do të ushtrojnë ndikim përcaktues në zhvillimin atipik të epistemologjisë letrare shqiptare, si dhe do të shërbejnë si logjistikë për përveçimin dhe izolimin e pjesëve ndërmjet vetes dhe të tyre në raport me perspektivën e formimit të së tërës në njohjen letrare shqiptare. Varësisht nga përmbajtja e qëllimeve drejt të cilave do të jenë të orientuara sistemet shoqërore e politike në Shqipëri dhe në Jugosllavi, do të zbatohet mënyra e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e hegjemonisë politike ndaj paradigmave njohëse letrare shqiptare. Në refleksionin për letërsinë shqipe, pas Luftës së Dytë Botërore e tutje, përplasia ndërmjet modeleve metodologjike njohëse letrare do të jetë në raport të drejtë me shkallën e largimit të tyre nga bërthama e tërësisë së sistemit letrare shqiptar në drejtim të harmonizimit të plotë të tyre me objektivat hegjemone të sistemeve politike e shoqërore në të cilat ato do të zbatohen.

E përbashkëta e raportit hegjemon të këtyre dy formave të diskurseve politike ndaj diskursit njohës letrar shqiptar, si në rastin kur ajo do të shfaqet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu edhe në rastin kur ajo do të shfaqet në mënyrë të tërthortë, është se diskursi politik do të jetë ajo "fuqi universale" e cila do të synojë që ta përthithë diskursin njohës letrar si "forcë të vecantë", me pretendimin që shkaktarët e ndryshimit, që burojnë nga ligjet e brendshme të diskursit njohës letrar, t'ia nënshtrojnë ligjeve të brendshme të tij. Dallimi, ndërkaq, ndërmjet mënyrës së drejtpërdrejtë dhe mënyrës së tërthortë të krijimit të marrëdhënies hegjemone të diskursit politik me diskursin njohës letrar ka të bëjë me faktin se derisa në rastin e parë forca hegjemone e "karakterit universal" e diskursit politik do të jetë e dukshme dhe jo e natyrshme, në rastin e dytë ajo do të jetë e padukshme, depërtuese dhe me pre-

tendimin që të paraqitet e natyrshme dhe në harmoni me ligjin e domosdoshmërisë së zhvillimit të diskursit njohës letrar. Në qoftë se në rastin e parë hegjemonia e diskursit politik brenda vetës do të përfshijë "ideologjinë deterministe", sipas së cilës "ajo që ndodh" është e dëshirueshmja e domosdoshme; në rastin e dytë hegjemonia e liberalizmit do të përfshijë "ideologjinë e interdeterminizmit", sipas së cilës "oferta jonë" është "zgjedhja juaj e lirë". Totaliteti hegjemon i politikës duke qenë në funksion të policentrizmit të mendimit kritik letrar shqiptar, do ta ndjekë strategjinë e fuqizimit të kategorisë së shumëllojshmërisë për ta bërë të padukshëm raportin e saj me njëshin e vet dhe vetekzistencën e njësisshmërisë si identiteti shqiptar.

Derisa në Shqipëri, menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, ideologjia klasore do të jetë "baza frymore" e realizmit socialist, si doktrinë që do të përcaktojë qëllimet e epistemologjisë letrare; në Kosovë, në fillim të viteve 70, liberalizmi, si doktrinë e kolonializmit të Jugosllavisë avnojnë, do t'i përcaktojë koordinatat e mendimit kritik letrar për trajtimin imanent të letërsisë [7]. Në Shqipëri, si njëra qendër e mendimit kritik letrar shqiptar, sistemi politik etatist do të shërbejë si forcë materiale për vënien në lëvizje të doktrinës së realizmit socialist, i cili letërsinë dhe mendimin kritik letrar do ta konceptojë si medium për përmbushjen e nevojave praktike ideologjike shtetërore, me ç'rast raporti hegjemon ndaj diskursit njohës letrar shqiptar do të jetë i drejtpërdrejtë.

Përkundër kësaj, në Kosovë, qendër e dytë kjo e rëndësishme e mendimit kritik letrar, koncepti i trajtimit të brendshëm, ahistorik dhe antihistorik i veprës letrare, që në momentin e shfaqjes së vet brenda sistemit epistemologjik letrar shqiptar do të përpiqet të "natyralizohet" nëpërmjet teorisë së "lirisë së shprehjes" dhe teorisë së "prirjeve individuale krijuese" të "pavarura nga ideologjia shtetërore". Në qoftë se në rastin e parë subjekti njohës do të "akomodohet" në "hapësirën" e objektit njohës, si praktikë jetësore, politike e ideologjike; në rastin e dytë është objekti njohës që do të "akomodohet" brenda subjektit njohës, i cili do të bëhet bartës dhe interpretues i tij. Në

qoftë se në rastin e parë dukja e utilitarizmit e ideologjisë klasore do të jetë gjithëpërfshirëse, sepse atë do ta bëjnë të pranishme gjithandej aparatet represive shtetëror (në kuptimin althusserian) të Shqipërisë komuniste në procesin e jetësimit të saj; në rastin e dytë liberalizmi, si doktrinë e kolonializmit jugosllav, me ndikim në orientimin dhe strukturimin e mendimit kritik letrar shqiptar, hegjemoninë e vet do ta ushtrojë jo nëpërmjet aparateve represive shtetërore, por nëpërmjet aparateve ideologjike, si institucione të ndërmjetme (institucioneve arsimore, shoqatave, grupeve të ndryshme sociale, individëve etj.).

Doktrina e liberalizmit, si një nga format e ideologjisë komuniste, në raport me doktrinën etatiste, padyshim do të jetë një mundësi e re objektive për zhvillimin e potencialeve subjektive të subjektit kolektiv shqiptar në Jugosllavinë avnojane. Por sa do të shfrytëzohen këto mundësi? Në çfarë drejtimesh këto mundësi objektive do të shfrytëzohen prej mundësive subjektive? A do të bëhen subjektet individuale apo kolektive "vendbanime për mundësitë objektive" dhe "vendbanime" për interesin e identitetit tërësor letrar shqiptar, e më këtë edhe të identitetit kombëtar shqiptar? A do të ndikojnë këto mundësi për vetëndërgjegjësimin e subjektit njohës shqiptar për situatën e vet në raport me qëllimin dhe realitetin e subjektit kolektiv brenda Jugosllavisë avnojane, apo për situatën dhe qëllimin me perspektivë historike të subjekti unik kolektiv shqiptar?

Mund të thuhet se liberalizmi, si doktrinë e komunizmit jugosllav dhe si formë e ideologjisë koloniale, do të vihet në shërbim dhe do të ndikojë, në masë të madhe, në thellimin e përplasjes së vizioneve përveçuese brenda subjektit njohës dhe në intensifikimin e procesit të copëzimit të orientimeve të vullneteve dhe dëshirave brenda tërësisë së subjektit kolektiv shqiptar. Pluraliteti i alternativave, duke qenë ofertë-qëllim për subjektet individuale, e jo ofertë-mjet për shpjegimin dhe të kuptuarit e objektit njohës (në këtë rast atij letrar), do të vihet në funksion të largimit prej qëllimit pa alternativë të trajtimit unicentrist të letërsisë shqiptare, e me këtë edhe nga ideali për t'u marrë me zgjidhjen e problemeve thelbësore

me rëndësi për qenien e njësishe të kulturës kombëtare shqiptare.

Një doktrinë e tillë, në rrafshin e epistemologjisë letrare shqipe, duke e inauguruar ahistoricizmin si koncept metodologjik dhe si qëndrim ndaj botës, do të ndikojë në thellimin e ndarjes së të njejtës dhe të të ngjashmes. Në qoftë se etatizmi në Shqipëri, si aspekt i ideologjisë klasore dhe si realitet i mundësive objektive, do të vihet në funksion të mundësive subjektive të subjekteve individuale apo kolektive që ato të orientohen kah afirmimi i konceptit të historicizmit pozitivist si instrument mbizotërues metodologjik i mendimit kritik letrar, i cili letërsinë do ta konceptojë si pjesë integrale të historisë së popullit shqiptar; liberalizmi në Kosovë, si mundësi objektive, do të përmbajë dy pista për mundësitë subjektive: njerën e cila do të vihet në funksion të mundësive subjektive me orientim për afirmimin e konceptit antihistoricist, i cili do të ndikojë në shpërbërjen e kohezionit të brendshëm të pjesës në raport me tërësinë, ndërmjet traditës dhe perspektivës historike të zhvillimit të së tërës letrare shqiptare dhe historicizmit, i cili do të bazohet në ndërveprimin shkakor dhe dialektik ndërmjet veprës dhe faktorëve historiko-shoqërorë e kulturorë si dimension thelbësor i logjikës së njohjes dialektike të tërësisë së realitetit objektiv. Historicizmi pozitivist veprën artistike do ta konceptojë si epifenomen shoqëror, ndërkaq historicizmi integral veprën artistike do ta vështrijë si epifenomen shoqëror dhe si genie autonome estetike. Një historicizëm i tillë "joautokratik" do të krijojë një pamje më të plotë për forcën kohezive ndërmjet pjesëve dhe tërësisë si dhe ndërmjet traditës dhe perspektivës historike të zhvillimit të së tërës letrare shqiptare. Efektet çintegruese të konceptit ahistoricist dhe antihistoricist të tipit poststrukturalist dhe të tipit të kritikës së re (asnjëherë të përvetësuar dhe të zbatuara drejt dhe besnikërisht, por më shumë të deklaruara verbalisht) të inauguruar në mendimin kritik letrar në Kosovë në fillimvitet '70, në botën postbipolare, në fillimvitet '90 do të manifestohen me thellimin artificialisht të diversitetit policentrik të mendimit kritik letrar ndërmjet dy qendrave kombëtare: Tiranës dhe Prishtinës; me tendencën për krijimin e identiteteve të veçanta

letrare mbi bazën e kriterit të njëjësive administrativo-politike.

Në qoftë se rrënjësja e vizionit çintegruës në mendimin kritik letrar në botën bipolare do të arsyetohet me motive profesionale krijuese (pluraliteti metodologjik), në botën postbipolare vizioni çintegruës do të arsyetohet me motive politike, që tani do të marrin karakter të “interesit kombëtar”, siç do të thonë, “interesit për krijimin e identitetit të ri kosovar” e me këtë edhe të të ashtuquajturit komb kosovar, si “kusht” për krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës (!).

PËRFUNDIM

Si përfundim mund të themi se për shkak të ndikimit përcaktues të gjeopolitikës në botën bipolare si dhe në atë postbipolare, në epistemologjinë letrare shfaqja e fenomenit të pluralitetit metodologjik letrar në fillimvitet 70 në Kosovë si dhe në vitet 90 në Shqipëri brenda hapësirës sinkronike të tij – ashtu sikurse edhe trajtimi dogmatik i letërsisë – nuk do të vijë si nevojë për zgjidhjen e problemeve anomike brenda epistemologjisë letrare, por do të jetë rrjedhojë e luftës anomike të ideologjive të ndryshme, të

cilat mendimin kritik letrar do ta shfrytëzojnë si trampolinë për përmbushjen e synimeve të veta.

Në qoftë se epistemologjia letrare shqiptare në kontekstin e gjeopolitikës bipolare do të jetë në varësi të synimeve të ideologjisë klasore në Shqipërinë londineze dhe asaj liberale – si doktrinë e kolonializmit – në Jugosllavinë avnojane, në kontekstin e gjeopolitikës postbipolare (globalizmit) epistemologjia letrare shqiptare ka tendenca t’i nënshtrohet ideologjisë provinciale të përveçimit.

BIBLIOGRAFIA

1. ALTHUSSER, L. 1971. *Ideology and Ideological State Apparatuses*, Lenin and Philosophy, London, New Left Book.
2. ANTONEN, P.J. 2005. “Tradition and Political Identity.” *Tradition through Modernity*, Studia Fennica Folkloristica 15, Helsinki.
4. GYSHE, I. & Dëmalda, Zh.M. 2005. *Historia e ideve politike II*, Dukagjini, Pejë, f. 430-5-6. *Po aty*, f. 435.
7. UÇI, A. 1970. *Estetika, jeta, arti*, Tiranë, f. 171.
8. THORNTON, A.P. 1965. *Doctrines of Imperialism*, John Wiley & Sons, New York, London, Sydney, f. 154.